



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 652/1 Prot.

Tiranë, më 27.01. 2025

U D H Ë Z I M

Nr. 10, datë 27.01. 2025

PËR

ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT  
BAZË, VITI SHKOLLOR 2024-2025

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të urdhrin nr.609 datë 20.12.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

U D H Ë Z O J:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë të sesionit të parë, për vitin shkollor 2024-2025 të zhvillohen në datat si më poshtë:
  - a) Lënda "Gjuhë shqipe", më 19 qershor 2025.
  - b) Lënda "Matematikë", më 25 qershor 2025.
  - c) Lënda "Gjuhë e huaj" e parë, më 30 qershor 2025.
  - d) Lënda "Gjuhë amtare", për nxënësit e pakicave kombëtare më 20 qershor 2025.
2. Nxënësit e pakicave kombëtare vlerësohen në lëndët: "Gjuhë amtare", "Gjuhë shqipe", "Matematikë" dhe sipas dëshirës edhe në një gjuhë të huaj.
3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhrin nr. 74, datë 15.02.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë".
4. Gjuhët e huaja që do të jepen si provim i detyruar janë: "Anglisht", "Frëngjisht", "Italisht" dhe "Gjermanisht". Testi i gjuhës së huaj të parë hartohet në përputhje me

gjuhën e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

5. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe franceze, italiane dhe gjermane japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.
6. Provimet fillojnë në orën 10:00 dhe çdo provim zgjat 2 orë e 30 minuta.
7. Nxënësit me aftësi të kufizuar që ndjekin shkollat e zakonshme, i zhvillojnë provimet kombëtare të arsimit bazë, sipas përcaktimeve në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë.
8. Drejtuesi i Institutit të nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi” e tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.
9. Çdo zyrë vendore e arsimit parauniversitar merr nga qendrat e vlerësimit të testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe në QSHA.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTËR**

**ORJANA OSMANI**

